




Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Zyra e kryetarit të komunës

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 12 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 dhe në bazë të kërkesave të Drejtorisë për Administratë dhe Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, shpall:

K O N K U R S

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

**Drejtoria për Administratë- Komuna e Vushtrrisë**

**Vendet e punës: Asistentë të Zyrtarëve të Gjendjes Civile**

Numri i ekzekutueseve: tre (3)

Lloji i pozitës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta ( kohëzgjatja 6 muaj)

Orari i punës: 40 orë në javë

Paga: 303.01

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve për qytetarët në Zyrën e Gjendjes Civile

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi;

- 1.Verifikimi i qytetarëve në regjistrin themeltar elektronik dhe shënimeve në regjistrat themeltar fizik;
- 2.Mirëmbajtja dhe kujdesi për regjistrin themeltar dhe qendror si në aspektin fizik, ashtu edhe elektronik dhe dokumenteve të arkivuara;
- 3.Përditësimi i shënimeve dhe regjistrit të shtetaseve në regjistrin themeltar dhe qendror;
- 4.Përdorimi dhe zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve që kanë të bëjnë me gjendjen civile;
- 5.Përdorimi dhe shfrytëzimi i aplikacionit të GJC, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë;
- 6.Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile si: lindjet, martesat, vdekjet.

Kualifikimi profesional, aftësitë dhe përgjegjësitë:

Diplomë universitare nga shkencat shoqërore

**Vendi i punës: Asistent të Zyrtarit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë**

Numri i ekzekutueseve: Një (1)

Lloji i pozitës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta ( kohëzgjatja 6 muaj)

Orari i punës: 40 orë në javë

Paga: 303.01

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve në QSHQ

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi;

- 1.Në QSHQ, ofron shërbime administrative për qytetarë;
- 2.E ndihmon stafin e QSHQ-se në punën rreth shërbimeve me qytetarë;
- 3.Shpërndan kërkesat, shkresat dhe aktet tjera nëpër drejtori dhe sektorë;
- 4.Për të gjitha punët mban raport dhe shënime.

Kualifikimi profesional, aftësitë dhe përgjegjësitë:  
Diplomë universitare nga shkencat shoqërore

**Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural- Komuna e Vushtrrisë**

Vendet e punës: **Zyrtar për digjitalizimin e të dhënave në sektorin e bujqësisë**

Numri i ekzekutuesve: tre (3)

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta (kohëzgjatja 6 muaj),

Orari i plotë: 40 orë në javë

Paga: 423.85 euro bruto

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve për digjitalizimin e lëndëve.

Pranimi i aplikacioneve dhe përpunimi i lëndëve për subvencionime dhe digjitalizimi i të dhënave ;

- 1.Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësisë;
- 2.Pranon aplikacionet për subvencione;
- 3.Përgatit lëndët, kërkesat dhe ju jap udhëzime bujqve lidhur me subvencionet ;
- 4.Bënë digjitalizimin e të dhënave;

Kualifikimi profesional, aftësitë, përgjegjësitë:  
Përgatitja universitare – lëmi i bujqësisë, e përfresuese  
Përvoja e punës e preferueshme

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në QSHQ ose në faqen e internetit të komunës [www.kk.rks.gov.net/vushtrri](http://www.kk.rks.gov.net/vushtrri) dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është dënuar dhe nën hetime. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 33),nr. i tel. 038 200 42 435.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri